

VENDIM
Nr. 721, datë 5.12.2018

PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË BILETAVE TË TEATRIT KOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave
VENDOSI

1. Miratimin e tarifës së biletave për Teatrin Kombëtar, sipas tabelës në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Të ardhurat e realizuara nga shitja e biletave do të përdoren: 30% për llogari të Teatrit Kombëtar, sipas limitit të përcaktuar në planin e shpenzimeve, dhe 70% do të derdhen në buxhetin e shtetit.

3. Në asnjë rast, këto të ardhura nuk do të përdoren për shpërblimin e punonjësve.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Teatri Kombëtar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
ÇMIMET E BILETAVE PËR TEATRIN KOMBËTAR

Nr.	Kategoria e biletës	Çmimi
1	Ditët e javës (e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte)	300 lekë
2	Fundjavë (e premte, e shtunë, e diel)	500 lekë